



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 408/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë , duke vendosur përkitazi me ankesën e Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj , paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së pankartave dhe njoftimeve në objektet publike, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

I. Miratohet si e bazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

II. Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Ferizaj i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi **ndërsa Hasan Mani** kandidat për këshilltar komunal në komunën e Ferizajt nga radhët e LVV-së, detyrohet të largohet nga lista e kandidatëve dhe i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 5 vite nën autoritetin e KQZ-së si kandidat apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor.

Arsyetim

Me datën 31. 10. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se me datën 30.10.2013 rreth orës 13:30 në objektin e shkollës së mesme bujqësore “Zenel Hajdini” kandidati i LVV-së për kuvendin komunal të Ferizajt me nr. 22 Hasan Mani mësimdhënës në këtë shkollë publikisht dhe në sallë të profesorëve të kësaj shkolle ka vendosur materiale të shtypura nga gazetatat ditore që kanë të bëjnë me subjektin politik PDK me të cilat shkrime ka nxitur urrejtje kundër subjektit politik PDK ku me ç’rast ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të sanksionuara me Rregullën Zgjedhore 11/2013. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë CD me incizime dhe foto nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LVV, me datën 31.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 01.11.2013, ora 16:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga LVV-ja, në të cilën përgjigje theksohet shtabi i LVV-së ka nxjerrë vendim kundër kandidatit Hasan Mani me të cilin e njofton se për shkak të veprimeve të tij në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e nxjerra nga LVV-ja dhe rëndësinë e shkeljes së kryer nga i sipërpërmenduri, ka vendosur largimin tij nga LVV-ja si kandidat i LVV-së duke u bazuar në rregulloren e brendshme të

LVV-së. Andaj sipas përgjigjes në kërkesë LVV-ja konform nenit 32.6 ka bërë përpjekje duke ndërmarr veprime konkrete për tu informuar kandidatët, anëtarët dhe mbështetësit e saj lidhur me obligimet që dalin nga Kodi i Mirësjelljes dhe se lidhur me këtë LVV-ja ka përgatitur një qarkore të cilën e ka shpërndarë nëpër të gjitha qendrat e saja dhe te njëjtën e kane vene ne tabelën e njoftimeve e cila është e qasshme për të gjithë anëtarët mbështetësi dhe kandidatet e saj dhe se personi në fjalë ka kryer një veprim të tillë pa dijeninë e subjektit politik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës si dhe nga CD-ja e incizuar shihet qartë se si kandidatit nga radhët e LVV-së Hasan Mani ka vendosur materiale me karakter zgjedhor brenda hapësirave të shkollës Zenel Hajdini në komunën e Ferizajt, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se LVV-ja ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe rregullat zgjedhore po ashtu rrethanë rënduese PZAP-i mori se kandidati Hasan Mani, ka vepruar në kundërshtim me nenin 35.1 të LZP-së që përcakton veprimet e ndaluara nga ana e shërbyesve publik, andaj vendosja e materialit nga ana e kandidatit të saj Hasan Mani brenda hapësirave publike e bënë përgjegjës personin në fjalë dhe vetë subjektin politik LVV. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori parasysh faktin se LVV, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, ka ndërmarr veprimet konkrete sipas nenit 32.6 ndërsa si rrethanë tjetër lehtësues konsiderohet edhe fakti se LVV-ja me këtë rast ka larguar menjëherë kandidatin e saj nga lista për ansambleist të komunës nga LVV-ja.

Duke u bazuar në të cekurat më lartë PZAP-i konstaton se subjekti politik LVV respektivisht kandidati i saj Hasan Mani, ka shkelur nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakateve, posterave apo të slloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave.

Andaj meqenëse kandidati nga radhët e LVV-së ka bërë shkeljen e konstatuar më lartë si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të këtij subjekti që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e tjera

të ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 120.3 pika a) dhe pika d) dhe nenit 35.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 408/2013 më datën 04.11.2013.

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*